

VENDIM
Nr.101, datë 17.5.2007

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN
ZGJEDHORE**

Në mbështetje të nenit 77 pika 1 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Ngrihet Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore.
- II. Komisioni ka për detyrë përgatitjen e amendamenteve të nevojshme të kuadrit ligjor, për arritjen e standardeve në zgjedhjet politike dhe administrative.
- III. Komisioni përbëhet nga 18 anëtarë, 9 nga shumica dhe 9 nga opozita parlamentare. Anëtarët që i përkasin shumicës parlamentare caktohen: 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, 2 nga Grupi Parlamentar i Partisë Republikane, 2 nga Grupi Parlamentar Demokristian, 1 nga Grupi Parlamentar “Demokrat-Reformator”, 1 nga Grupi Parlamentar i Partisë Agrare Ambientaliste, 1 nga Grupi Parlamentar “Qendra Demokrate”. Anëtarët që i përkasin opozitës caktohen: 3 nga Partia Socialiste, 2 nga Partia Social-Demokrate, 2 nga Partia Lëvizja Socialiste për Integritet, 1 nga Partia Aleanca Demokratike, 1 nga Partia Demokracia Sociale.
- IV. Komisioni i Posaçëm Parlamentar drejtohet nga dy bashkëkryetarë: një nga Partia Demokratike dhe një nga Partia Socialiste.
- V. Pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar ngrihet grupi i ekspertëve teknikë. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij përcaktohen me vendim të Komisionit të Posaçëm Parlamentar.
- VI. Vendimet në komision merren me shumicën e votave (10 vota), kur pro tyre kanë votuar në unanimitet përfaqësuesit e dy partive të mëdha.
- VII. Komisioni ushtron veprimtarinë për një periudhë prej 3 muajsh nga data e vendimit.
- VIII. Ngarkohet Kryetarja e Kuvendit për krijimin e kushteve të punës dhe mbështetjen logjistike të veprimtarisë së komisionit.
- IX. Komisioni përbëhet nga këta anëtarë:

1. Ilir Rusmali (Bashkëkryetar)	-	PD
2. Arjan Starova	-	PD
3. Arjan Madhi	-	PR
4. Artur Hasanbelliu	-	PR
5. Ndue Shpani	-	PDK
6. Pashko Ujka	-	PDK
7. Tritan Shehu	-	PDR
8. Petrit Gjoni	-	PAA
9. Spiro Peçi	-	PBDNJ
10. Kastriot Islami (Bashkëkryetar)	-	PS
11. Fatmir Xhafa	-	PS
12. Alfred Dalipi	-	PS
13. Engjëll Bejtaj	-	PSD
14. Skënder Gjinushi	-	PSD
15. Sabit Brokaj	-	LSI
16. Ndre Legisi	-	LSI
17. Neritan Ceka	-	PAD
18. Paskal Milo	-	PDS

X. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)